



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:110697

Datë: 08.02.2021

Numri i dokumentit: 01484539

C.nr.949/16

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, me bashkëpunëtoreshen profesionale Gentiana Shabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.H. nga Ferizaji, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina dhe paditëses G.S. nga Ferizaji, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Daut Rudi, avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Filloreta Mustafa nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor dhe publik, më datën 08.02.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve R.H. dhe G.S. nga Ferizaji dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, për shkak të lëndimeve trupore të pësuar me rastin e shkakimit të aksidentit të datës 14.12.2009 nga i siguruari i të paditurës, t’iu paguaj paditësve shumat e specifikuar si më poshtë:

Për paditësin R.H.:

Kompensim në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej 4,768.00 euro, me kamatë ligjore, ashtu siç paguajnë bankat për mjetet e deponuara për 1 vit pa destinim të veçantë, të gjitha në afat prej 15 ditësh, duke llogaritur nga 19.03.2010 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Për paditësen G.S.:

Kompensimin në emër të dhembjes shpirtërore për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për të lindur shumë prej 120,000.00 €, me kamatë ligjore, ashtu siç paguajnë bankat për mjetet e deponuara për 1 vit pa destinim të veçantë, duke filluar nga data 28.12.2020 si datë e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, krejt kjo në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, që paditësve R.H. dhe G.S. në mënyrë solidare t’ua bëjë kompensimin e shpenzimeve të procedurës, në shumën prej 5,483.50 €, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit R.H. dhe G.S. nga Ferizaji, në Gjykatën Komunale në Gjilan, tani Gjykata Themelore në Gjilan, përmes përfaqësuesve të tyre me autorizim, kanë paraqitur padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dardania”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, duke theksuar se më dt. 14.12.2009, rreth orës 07.20 min, në rrugën regjionale Gjilan-Ferizaj, konkretisht në fshatin Partesh, ka ndodhur aksident trafiku me pasoja tragjike, në të cilin janë përfshirë automjeti i tipit “Golf” me targa 417 KS 215 dhe automjeti i tipit “Renault Clio” me targa 480-KS-058, ku si pasojë e këtij aksidenti nga lëndimet e pësura kishin vdekur dy persona, ndërsa paditësit kanë marrë lëndime të rënda trupore me pasoja të përjetshme, të cilët ishin në cilësinë e bashkëudhëtarëve në automjetin me targa 480-KS-058, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, Gjykata Komunale në Gjilan, më dt. 27.04.2012 ka nxjerr Aktgjykimin C.nr. 149/2010 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve R.H. dhe G.S., ndërsa pas vendosjes në lidhje me ankesën kundër këtij aktgjykimi, Gjykata e Qarkut në Gjilan përmes Aktvendimit AC.nr. 290/2012, të dt. 22.10.2012, i ka aprovuar ankesat e palëve ndërgjyqëse, ashtu që Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr. 149/2010 e ka prishur dhe lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Themelore në Gjilan, pas kthimit në rivendosje të kësaj çështje kontestimore, më dt. 27.02.2013 me Aktgjykimin e saj C.nr. 763/2012 ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve R.H. dhe G.S., e ndaj të cilit aktgjykim palët ndërgjyqëse kanë parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e cila gjykatë si gjykatë e shkallës së dytë me anë të Aktgjykimit AC.nr. 1934/2013, të dt. 08.11.2016, ka aprovuar pjesërisht ankesat e parashtruara, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr. 763/2012, të dt. 27.02.2013, në pjesët sa i përket pikave I, II, III, IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit i ka gjykuar vet, e më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa duhet të theksohet se për pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e shërimit për paditësin R.H. dhe pjesën e dispozitivit të aktgjykimit që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për dhembjet shpirtërore për humbjen e aftësisë së përhershme për të lindur fëmijë të paditëses Ganimete Salhiu, i ka kthyer në rigjykim.

Ndaj vendimit të lartëcekur, palët ndërgjyqëse (paditësit dhe e paditura) kanë parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, gjë që Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e revizionit, me anë të Aktgjykimit Rev.nr. 104/2017, të dt. 15.05.2017, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar revizionin e paditëses G.S., duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr. 1937/2013, të dt. 08.11.2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 763/2012, të dt. 27.02.2013, vetëm

përkitazi me kompensimin e gjykuar për paditësen në emër të shëmtimit trupor, ashtu që paditëses në emër të kompensimit për shëmtim trupor i është gjykuar shuma prej 4,000.00 €, ndërsa përtej kësaj shume, kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar. Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës, me anë të këtij aktgjykimi e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e paditësit R.H., të paditëses G.S. dhe të palës së paditur, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr. 1934/2013, të dt. 08.11.2013, përkitazi me pjesën tjetër të kompensimit të gjykuar me aktgjykimet e lartpërmendura, e që objekt trajtimi në këtë çështje kontestimore ka mbetur kërkesa e për kompensimin e shpenzimeve të shërimit për paditësin R.H., ndërsa për paditësen G.S. kërkesa për shpërblimin e dëmit për dhembjet shpirtërore për humbjen e aftësisë së përhershme për të lindur fëmijë.

Kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së parë, në procedurë të rigjykitimit, ka caktuar dhe mbajtur disa seanca gjyqësore, e të cilat seanca janë mbajtur në prani të palëve, përkatësisht të autorizuarve të tyre.

Gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit të parë R.H., av. Nysret Mjeku, ka deklaruar se: Mbeten në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar dhe fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar, ashtu që ta detyroj të paditurën që paditësit R.H. t'i paguaj shpenzimet e shërimit në shumë prej 4,768 euro me kamatë 8% nga data e kryerjes së pagesave për shërbimet e marra prej 14.12.2009 e deri në pagesën definitive, po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 2,148.00 € edhe atë shumën prej 1338 € për përfaqësim sipas aktgjykimit C.nr. 149/12 dhe shumën prej 810 € për përfaqësim në lëndën C.nr. 949/16 për 6 seanca të mbajtura (6x135€).

Përfaqësuesi me autorizim i paditëses së dytë G.S., av. Daut Rudi gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Mbeten në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar dhe fjalës përfundimtare, duke theksuar se paditësja në aksidentin e datës 14.12.2009, përveç lëndimeve të pësuar ajo ka pësuar edhe dhembje shpirtërore për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për të lindur, që nuk mund të përshkruhen dhe që eksperti ka konstatuar se: “nuk ka lëndim më të madh dhe të rëndë shpirtëror për humbjen e shpresës që të ketë fëmijë”. Tutje, ka shtuar se këto lëndime dhe pasoja janë të karakterit më të rëndë që mund t'i pësoj për së gjalli një grua, ashtu që edhe nga mendimi i Gjykatës Supreme është potencuar se në rastin konkret nuk mund të bëhet kompensim dëmi, por vetëm satisfaksion, ngase këto lëndime dhe pasojat janë të përhershme me përqindje në 100 %. Nga gjykata ka kërkuar që të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke kërkuar kështu edhe shpenzimet e procedurës edhe atë: shumën prej 78 € në emër të precizimit të padisë, shumën prej 300 € në emër të ekspertizave mjekësore, për përfaqësim të të autorizuarit shumën prej 2,957.50 € (7x422.50) sipas TOAK-ës, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë.

Përfaqësuesja me autorizim e të paditurës KS.”Eurosig” Sh.A, Filloreta Mustafa, gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaramëve të deritanishme si dhe fjalës përfundimtare, duke shtuar se akoma mbetet pranë

qëndrimeve që në këtë çështje kontestimore është arritur dhe kaluar limiti i mbulesës siguroese dhe për këtë të njëjtit janë në pritje të përgjigjes zyrtare nga BQK-ja, e nëse nga BQK-ja konfirmohet shuma e mbulesës siguroese, atëherë e paditura e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit R.H., për faktin se gjatë gjithë procedurës është konfirmuar fakti se ndërhyrjen të cilën e ka bërë paditësi në Maqedoni, të njëjtën e ka bërë pa marrë miratimin nga komisioni brenda QKUK-së që ky intervenim nuk mund të kryhet në Kosovë. Ndërsa për paditësen G.S., kërkesëpadinë e ka kundërshtuar pjesërisht si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, e sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykatës i ka propozuar që lidhur me to të njihen vetëm në bazë të suksesit në procedurë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat si në vijim: Të gjitha provat e administruara në procesverbalin për shqyrtimin kryesor të mbajtur më datën 27.02.2013; Ekspertizat me shkrim të ekspertit psikiatër dr. Afrim Cana si dhe mendimi dhe konstatimi i tij i dhënë në seancën e datës 24.09.2019; Ekspertizën me shkrim e dhënë nga dr. Rrahmon Hajdari dhe dr. Sejdullah Mahmuti, si dhe mendimi dhe konstatimi i dhënë në seancën për shqyrtimin kryesor nga eksperti dr. Rrahmon Hajdari, më dt. 11.12.2019.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, duke i marrë parasysh edhe udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj Ac.nr.1934/2013, të dt.08.11.2016 dhe nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev.nr. 104/2017 të datës 15.05.2017, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve R.H. dhe G.S., është e bazuar, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret, nuk ka qenë kontestues mes palëve fakti se më dt.14.12.2019 ka ndodhur një aksident i trafikut, e nga i cili aksident, paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore nga i siguruari i të paditurës, mirëpo, kontestues mes palëve është lartësia e kërkesëpadiës, në këtë rast lartësia e kërkesëpadiës për pjesët e kthyer në rigjykim. Gjykata, në rastin konkret vlerëson se baza juridike e kërkesëpadiës është e vërtetuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit R.H. dhe G.S., për shkak të aksidentit të dt. 14.12.2009, të njëjtit kanë pësuar lëndime të rënda trupore, fakte këto jokontestuese, por që gjykata me rastin e vendosjes nuk është marrë dhe nuk ka bërë zgjerimin e këtyre konstatimeve mjekësore për pjesët të cilat nuk janë kthyer në rigjykim, pasi që të njëjtat janë trajtuar, vendosur, vërtetuar dhe ndryshuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, andaj, gjykata në rivendosje i ka shqyrtuar vetëm faktet dhe provat të cilat kanë ndikim vendimtar në pjesën e mbetur për rivendosje, edhe atë vetëm sa i përket pjesës së kërkesëpadiës së paditësit R.H. lidhur me kërkesën për kompensim të shpenzimeve të shërimit të tij, dhe pjesës së kërkesëpadiës së paditëses G.S. lidhur me kërkesën e saj për shpërblimin e dëmit për dhembjet shpirtërore për humbjen e aftësisë së përhershme për të lindur fëmijë.

Nga sa u tha më lartë, gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe në harmoni me udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit, për vërtetimin e fakteve relevante në këtë çështje kontestimore *sa i përket pjesës së lartësisë së shpenzimeve të shërimit për paditësin R.H.*, në procedurë të rivendosjes ka shqyrtuar ekspertizen me shkrim të punuar nga ekspertët: dr. Rrahmon Hajdari, ortoped-traumatolog dhe dr. Sejdullah Mahmuti, specialist-kirurg (ekspertizë kjo e punuar në bazë të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejt të paditësit R.H.), ndërsa më dt. 11.12.2019 ka caktuar seancën për shqyrtim kryesor dhe e ka ftuar dhe dëgjuar ekspertin ortoped-traumatolog, dr. Rrahman Hajdari, i cili në mes të tjerash ka deklaruar se qëndron pranë mendimit dhe konstatimit të hartuar nga ai dhe kolegu i tij dr. Sejdulla Mahmuti, duke theksuar mes tjerash se paditësi R.H. me rastin e ndodhjes së aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore, e në raport me lëndimet e shkaktuara, paditësi është shëruar dhe ka shpenzuar, e që këto shpenzime përafërsisht janë ekuivalente dhe të arsyeshme lidhur me lëndimet, por që përgjigje të saktë nuk mund të jap për shkak se barnat mund të variojnë me çmime të ndryshme, por edhe shërbimet dallojnë nga Spitali në Spital dhe atë në spitale private çmimet janë më të larta.

Nga ekspertiza me shkrim e punuar nga ekspertët e cekur më lartë, dhe në bazë të mendimit dhe konstatimit të dhënë nga eksperti ortoped-traumatolog, dr. Rrahmon Hajdari në seancën e datës 11.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi për shkak të lëndimeve të pësuar nga aksidenti i dt. 14.12.2009, përveç lëndimeve të pësuar nga ky aksident, të njëjtit iu kanë shkaktuar edhe shpenzime për shërimin e tij. Po ashtu, gjykata nga kjo ekspertizë ka vërtetuar faktin se shpenzimet e shërimit kanë lidhje me lëndimet e pësuar nga ky aksident. Nga kjo rezulton se shpenzimet e shkaktuara paditësit për shërimin e tij kanë lidhje kauzale nga lëndimet e pësuar në aksidentin e dt. 14.12.2009. Për gjykatën, kjo ekspertizë, përkatësisht mendimi dhe konstatimi i dhënë nga ekspertët në ekspertizën me shkrim dhe gjatë seancës së dt. 11.12.2019 ka qenë e plotë dhe tejet profesionale, dhe në përputhje të plotë me shkresat e lëndës, përkatësisht provat e administruara, e po ashtu edhe në përputhje të plotë me gjendjen faktike të vërtetuar, pasi që nga ekspertiza e ekspertëve, e sidomos nga mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti dr. Rrahmon Hajdari në seancën e dt.11.12.2019 në mënyrë të qartë është sqaruar se shpenzimet e shkaktuara nga paditësi kanë lidhje me shërimin e tij, andaj, gjykata ia shprehi besimin e plotë kësaj ekspertize. Gjykata sa i përket vendosjes për lartësinë e shpenzimeve të shkaktuara nga paditësi për shërimin e tij në shumën e caktuar prej 4,768.00 euro, të njëjtat i ka vërtetuar në bazë të provave-faturave të cilat janë të deponuara në shkresat e lëndës dhe të administruara në seancën për shqyrtimin kryesor të mbajtur më datën 28.12.2020, pasi që në bazë të provave-faturave në fjalë është vërtetuar se paditësi për shërimin e tij ka shpenzuar shumën e cekur më lartë.

Po ashtu, gjykata, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AC.nr. 1934/13, të dt. 08.11.2016, në procedurën e rivendosjes, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore, edhe atë vetëm sa i përket pjesës së kërkesëpadiisë së paditëses G.S. të kthyer në rivendosje, ka shqyrtuar ekspertizën me shkrim të punuar nga eksperti psikiatër, dr. Afrim Canaj, ndërsa më dt. 24.09.2019 ka caktuar seancë gjyqësore dhe e ka ftuar ekspertin psikiatër, në këtë rast, dr. Afrim Canaj, për të marrë mendimin lidhur me atë se në çfarë mase janë dhe si manifestohen

dhembjet shpirtërore tek paditësja G.S., për shkak të humbjes së aftësisë së përhershme për të lindur fëmijë, krejt kjo me qëllim të shpërblimit të drejtë, i cili shpërblim do të paraqet satisfaksion për të mirën e cënuar. Eksperti gjatë kësaj seance ka deklaruar se në vitin 2011 kur është përpiluar ekspertiza, fokusi ka qenë i orientuar në raport me përjetimin e frikës të personave të aksidentuar, ndërsa duke marrë parasysh faktin që paditësja G.S. si pasojë e këtij aksidenti ka përjetuar humbje të organit, ka theksuar se tani është një momentum i ri, të cilit duhet t'i jepet një përkufizim lidhur me dhembjen shpirtërore të të njëjtës. Rasti i tillë cilësohet si rast specifik pasi që, e njëjta si pasojë e këtij aksidenti ka përjetuar dështim-aborti të padëshiruar dhe për shkak të lëndimeve të rënda ndaj të njëjtës është bërë intervenim kirurgjik, i cili ka rezultuar me heqjen totale të uterusit, që për pasojë të përhershme ka pamundësinë e të njëjtës për të krijuar familje, e që tek e njëjta kjo pasojë ka një ndikim direkt në mirëqenien dhe funksionimin e saj psikik. Lidhur me shkallën e intensitetit të dhembjes shpirtërore të paditëses G.S., për humbjen e mundësisë së të qenurit nënë, eksperti ka deklaruar se nuk ka lëndim më të madh dhe më të rëndë shpirtëror se humbja e shpresës për të pasur fëmijë, e që në rastin konkret karakterizohet me dy trauma, edhe atë, trauma e parë është ndërprerja e dhunshme e shtatëzanisë në muajin e pestë, si pasojë e aksidentit që ka ndodhur, ndërsa trauma e dytë është humbja e përhershme e aftësisë për të krijuar familje, prandaj kur ballafaqohemi me një realitet të tillë, natyrisht që jeta e individit ndryshon shumë dimensionalisht. Tutje, ka theksuar se për shkak të traumave të përjetuara nga ky aksident, e njëjta karakterizohet me një funksionim jo stabil, i cili shprehet përmes rënies së përgjithshme të performancës së saj në jetën e përditshme, por edhe simptoma të tjera emocionale si mungesa e perspektivës, rënia e vullnetit dhe dinamizmave të tjerë të jetës, sikur edhe problemet e vazhdueshme me pagjumësi, e cila për të gjitha këto shqetësime duhet të përdor terapi kohë pas kohe. Ndërsa lidhur me ndikimin e kësaj gjendje tek raporti në mes bashkëshortëve, i paditëses me familjen e saj dhe personat e tretë, eksperti ka deklaruar se nuk ka dyshim se një situatë e tillë mund të manifestohet edhe me kriza brenda çifteve bashkëshortore, e që kjo situatë ndikon edhe tek personat e tretë në familje sepse modeli i funksionimit të familjes tradicionalisht është i lidhur me ngjyrimet patriarkale dhe sigurisht se anëtarët e tjerë të familjes mund të kenë ndikime në faza të ndryshme gjatë jetës së bashkëshortëve.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ekspertiza e punuar nga ky ekspert është e plotë dhe në përputhje me shkresat tjera të lëndës dhe e njëjta pasqyron gjendjen reale dhe të plotë të paditëses, pasqyron gjendjen emocionale dhe shpirtërore të saj për shkak të lëndimeve të marra nga aksidenti i shkaktuar nga i siguruari i te paditurës, andaj gjykata kësaj ekspertize ia ka shprehur besimin e plotë.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata ka vendosur që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses G.S., për kompensimin në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për të lindur, në shumën prej 120,000.00 €, si satisfaksion për dhembjen aq të madhe shpirtërore, në rradhë të parë humbjen e fetusit gjatë aksidentit të pësuar, e më pastaj pamundësinë e përhershme të aftësisë për të lindur, ku ashtu siç edhe ka cekur eksperti i psikiatrisë, dr. Afrim Cana, se: “për një grua nuk ka dhembje më të madhe shpirtërore se sa humbja e shpresës për tu bërë nënë, pra për të pasur fëmijë”. Duke e ditë rëndësinë e të qenurit nënë në këtë botë si dhe qëllimi bazë i martesës dhe shoqërisë është riprodhimi shoqëror, e që

për paditësen kjo është e pamundur, asnjëherë dhe në asnjë rrethanë, nuk mund të ketë kompensim që e shpërblen në mënyrë ekuivalente dëmin dhe pasojën që i është shkaktuar paditëses nga ky aksident, e akoma më të rënduar këtë situatë e bën fakti se edhe pse shkenca ka evoluar në masë të madhe dhe janë shpikur metoda të fekondimit artificial për mbarësimin – mbetjen shtatëzënë të grave, në rastin konkret ashtu siç kanë konstatuar edhe ekspertët e gjinekologjisë, paditësja as me këto mundësi artificiale nuk mundet që të fitoj-kthej aftësinë e të qenurit nënë, konkretisht me mundësi minimale të mbes shtatëzënë dhe të ketë fëmijën e saj. Nga konstatimet e ekspertëve të lëmive përkatëse, përkatësisht ekspertiza e gjinekologjisë dhe psikiatrisë, është konstatuar dhe ardhur në përfundim se humbja e përhershme e aftësisë për të lindur shkakton pasoja në marrëdhëniet bashkëshortore, familjare dhe personat e tretë. Nisur nga një situatë e tillë, gjykata përveç të cekurave më lartë, vlerëson se tek paditësja kemi edhe cënim të dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik, të drejtë këto personale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pasi që me nenin 23 të Kushtetutës, është përcaktuar qartë se: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”*, ndërsa me nenin 26, është përcaktuar se: *“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin: (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj”*. Në interpretim të dispozitave të cekura më lartë, gjykata vlerëson se paditëses këto të drejta iu kanë cënuar, sepse të njëjtes përveç dhembjeve dhe lëndimeve të shkaktuara nga aksidenti i dt.14.12.2009, po ashtu, iu ka hequr detyrimisht një organ nga trupi i saj, në këtë rast uterus, që për pasojë të përhershme ka pamundësinë e të njëjtës për të krijuar familje. Nga këto dhe arsyet e cekura më lartë, tek paditësja këto pasoja të shkaktuara kanë një ndikim direkt në mirëqenien dhe funksionimin e saj psikik, e që është manifestuar dhe manifestohet me një funksionim jo stabil në jetë, i cili shprehet përmes rënies së përgjithshme të performancës së saj në jetën e përditshme, por edhe simptome të tjera emocionale si mungesa e perspektivës, rënia e vullnetit dhe dinamizmave të tjerë të jetës, sikur edhe problemet e vazhdueshme me pagjumësi, që të gjitha këto kanë lidhshmëri dhe ndikim tek raporti në mes bashkëshortëve, i paditëses me familjen e saj dhe personat e tretë, e që nuk ka dyshim se një situatë e tillë mund të manifestohet edhe me kriza brenda çifteve bashkëshortore. Nga të gjitha këto të lartëcekura, arsyetojnë në masë të mjaftueshme kërkesëpadinë e paditëses dhe arsyetojnë shumë e aprovimin të së njëjtës, vetëm si lloj satisfaksioni për dëmin me pasoja të përhershme që i është shkaktuar, sepse nuk ka kompensim në botë që të njëjtës mund t’ia shpërblej dëmin e shkaktuar, por vetëm si lehtësim dhe kënaqje ashtu siç është edhe obligimi ligjor - rëndësia e cënimit të të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.

Gjykata i ka shqyrtuar dhe vlerësuar edhe pretendimet e të paditës, respektivisht të autorizuarës së saj, lidhur me atë se pala paditëse R.H. ndërhyrjen të cilën e ka bërë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të njëjtën e ka bërë pa marrë miratimin nga komisioni brenda QKUK-së që ky intervenim nuk mund të kryhet në Republikën e Kosovës, mirëpo, gjykata vlerëson dhe konstaton se një pretendim i ketillë nuk qëndron, ngase për gjykatën është relevante çështja e ofrimit të mbrojtës gjyqësore të palëve të cilat kërkojnë mbrojtje gjyqësore nga gjykata dhe kjo sigurisht se ka rëndësi të madhe pasi ofrimi i mbrojtjes sa më të shpejtë gjyqësore me qëllim të sanimit dhe lehtësimit të gjendjes së rënduar të palëve që kërkojnë mbrojtje, ndërsa është krejt çështje tjetër dhe përzgjedhje individuale vendi se ku është dashur

paditësi R.H. të kryej intervenimin, pasi që për paditësin ka qenë imediate shërimi sa më i shpejtë për të mos ardhur deri tek keqësimi i gjendjes shëndetësore dhe i njëjti shpenzimet lidhur me shërimin e tij i ka të gjitha të argumentuara përmes faturave të cilat janë të deponuara në shkresat e lëndës te cekure si me lartë, andaj mbi bazën e kësaj mbulesë për shpenzime të shërimit për paditësin R.H., gjykata ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit për shumën e kërkuar prej 4,768.00 €, shumë kjo e cila do t'i shërbej paditësit për kompensimin për shumën të cilën i është dashur t'a jap për shpenzime të shërimit për shkak të lëndimeve të pësuar nga aksidenti i datës 14.12.2009. Sipas Ligjit për Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Qytetarit në Kujdesin Shëndetësor, më konkretisht me nenin 5 të këtij ligji, parashihet se: *“Qytetari ka të drejtë, që të konsultohet dhe të trajtohet nga mjeku, të cilin e zgjedh vetë, me pëlqimin e institucionit shëndetësor, brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe rregullat operative të institucionit”*, ndërsa me nenin 10 të këtij ligji, është përcaktuar qartë se: *“Brenda kornizës së realizimit të së drejtës të vendimit personal, qytetari është i lirë që të vendosë se a dëshiron që të shfrytëzojë shërbimet shëndetësore apo jo, si dhe me cilat intervenime të pajtohet dhe cilat intervenime t'i refuzojë, duke pasur parasysh kufizimet e përcaktuara me ligj”*. Në interpretim të dispozitave të këtij ligji, dhe në bazë të rrethanave të cekura më lartë, gjykata vlerëson se është e drejtë e çdo qytetari të përzgjedh vendin dhe institucionin ku dëshiron të shërohet dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore sipas këtij ligji, qoftë në institucione publike apo private, e ne rastin konkret paditësi R.H. ka pasur të drejtë të përzgjedh vendin e shërimit në bazë të bindjes dhe vullnetit të tij, sepse kërkesa për një gjë të tillë ka qenë imediate, pasi që shtyerja për një kohë më të gjatë ka rrezikuar shëndetin e tij edhe ashtu të rënduar nga ky aksident, dhe vendimi i tij për të kërkuar trajtim jashtë vendit, në këtë rast në një shtet tjetër nuk ka qenë aspak në kundërshtim me lirinë e tij për të zgjedhur vendin ku dëshiron të kërkojë shërbime shëndetësore, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, gjykata ka shqyrtuar dhe analizuar edhe pretendimin tjetër të përfaqësueses së të paditurës, lidhur me arsyet e cekura se pala paditëse nuk mund të kompensohet pasi që është tejkaluar limiti i mbulesës siguroese, mirëpo, sipas vlerësimit dhe bindjes së gjykatës, nuk është relevant ky fakt, pra nuk është relevant fakti se a ka tejkaluar apo jo mbulesa siguroese e të paditurës për të u liruar nga përgjegjësia në kompensimin e palës së dëmtuar, në këtë rast palën paditëse, sepse, aksidenti ka ndodhur me fajin e të siguarit të të paditurës, fakt ky i cili nuk është kontestues nga palët ndërgjyqëse, dhe me rastin e shkaktimit të aksidentit palët e treta që pësojnë, është obligim ligjor të kompensohen, palët paditëse kanë kërkuar mbrojtje gjyqësore për shkak të lëndimeve të marra dhe është obligim i gjykatës që të caktojë shumën e kompensimit të dëmit si shpërblim për lëndimet e pësuar nga aksidenti i dt.14.12.2009, ndërsa a është tejkaluar apo jo kjo mbulesë siguroese nuk është relevante, sa është relevante shpërblimi i dëmit për paditësit për dhembjet dhe lëndimet e pësuar, pra jeta, trupi dhe shëndeti i njeriut në këtë rast është primar, ashtu siç edhe gjykata është e obliguar të ofroj mbrojtjen gjyqësore për kompensimin e të dëmtuarve. Gjukata, nga të njëjtat arsye, në seancën e mbajtur me dt.28.12.2020, ka refuzuar propozimin e të autorizuarës së të paditurës, përmes të cilit propozim ka kërkuar nga gjykata që të kërkojë mendim nga BQK, lidhur me limitin e mbulesës siguroese kur ka qenë i siguar automatikisht-shkaktari i këtij aksidenti, përkatësisht në periudhën prej 03.11.2009-03.11.2010.



Gjykata, me rastin e vendosjes, përveç dispozitave të cekura më lartë, si dispozita materiale ka aplikuar edhe dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), përkatësisht nenet: 154, 155, 158, 185, 195, 200 të këtij ligji. Sipas nenit 154 të LMD është përcaktuar se: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij"*, ndërsa sipas nenit 155 të po këtij ligji, është përcaktuar se: *"Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhembjes ose të frikës fizike apo psikike (demi jomaterial)"*. Ndërsa sipas nenit 158 të këtij ligji, është përcaktuar se: *"Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia"*. Nga dispozita e nenit 185 të ligjit të lartëcekur është paraparë saktë se: *"Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkactohej dëmi dhe në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla"*. Ndërsa me nenin 195 të po këtij ligji, është paraparë se: *"Kush i shkakton tjetrit lezonim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paafësisë për punë gjatë kohës së mjekimit"*. Me nenin 200 të po këtij ligji, janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jomaterial, e nga e cila dispozitë është përcaktuar se: *"Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material"*. Tutje, në po të njëjtin nen, citohet: *"Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror"*.

Nga sa u tha, dhe në interpretim të dispozitave ligjore të cekura më lartë, gjykata vlerëson se kompensimi i caktuar dhe vendosur nga gjykata me këtë aktgjykim është adekuat sa i përket kompensimit të paditësve për dëmet e pësuar nga aksidenti i shkaktuar nga i siguruari i të paditurës në datën dhe mënyrën e përshkruar si më lartë, dhe ky kompensim sipas vlerësimit të gjykatës është real dhe paraqet një lloj satisfaksioni të vërtetë për atë që është e mundur duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatë ka vendosur në mbështetje të nenit 277 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e që është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që me kete mendim janë sqaruar dispozitat ligjore për gjykimin e kamatës në çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452 paragrafi 2 të LPK-së, sipas së cilës paditësve i pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 5,483.50 € edhe atë shumën prej 1338 € për përfaqësim sipas aktgjykimit C.nr. 149/12 dhe shumën prej 810 € për përfaqësim në lëndën C.nr. 949/16 për 6 seanca të mbajtura (6x135€) për përfaqësuesin e palës paditëse, ndërsa shumën prej 78 € në emër të precizimit të padisë, shumën prej 300 € në emër të ekspertizave mjekësore, për përfaqësor të të autorizuarit shumën prej 2,957.50 € (7x422.50) sipas TOAK-ës.

Nga të sipër përmendurat u vendos si më lartë, e konform nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 949/2016, më datë 08.02.2021**

**Gjyqtari,**  
**. Blerim BESHTICA**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.